



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/20023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 04.02.2025, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Mbyllet rasti APK-DPKI-06-1436/24, për zyrtarin e lartë z. Edmond Beqiri, Prorektor në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë, për shkak të është shmangur gjendja e papajtueshmërisë me ushtrim të funksionit publik.

A r s y e t i m

Rasti i hapur (sipas një raportimi) nën dyshimin për papajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Edmond Beqiri, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në tekstin e mëtutjeshëm: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Ky rast ka filluar të trajtohet pasi ishte raportuar nga një denoncim nga jashtë duke aluduar se zyrtari z. Edmond Beqiri, krahas ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë publik, respektivisht Prorektor në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë, ishte edhe Kryetar Bordi në OJQ-në: “Agjencia për Financim në Kosovë”.

Agjencia duke zhvilluar procedurat e parapara ligjore ka vërtetuar gjendjen se i njëjti është edhe person i autorizuar në OJQ-në, “Agjencia për Financim në Kosovë”.

Në pajtim me nenin 22, paragrafin 3 dhe 5 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka dërguar shkresën zyrtare APK-DPKI-1611/24, duke e njoftuar zyrtarin e lartë për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së papajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik.

Me qëllim të sqarimit të plotë dhe të gjithanshëm të këtij rasti është organizuar dhe mbajtur një takim me z. Edmond Beqiri, në ambientet e Agjencisë lidhur me këtë rast. Në këtë takim zyrtarit në fjalë i janë bërë të ditura pretendimet dhe provat në dispozicion si dhe i është sqaruar fakti se gjatë ushtrimit të funksionit publik, ai nuk mund që njëkohësisht të mbajë funksion drejtues e as të jetë përfaqësues i autorizuar në Organizatë Joqeveritare(OJQ), sepse kjo situatë paraqet gjendje

të papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, siç përcaktohet me nenin 13, paragrafi 1, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ku thuhet se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit”.

Në këtë takim z. Edmond Beqiri, është pajtuar me faktet e paraqitura duke u arsyetuar se nuk ka qenë i njoftuar me papajtueshmëritë lidhur me këtë rast, dhe ka deklaruar se do marr veprimet e duhura në pajtim me ligjin për të shmangur situatën e konfliktit të interesit.

I njëjti, përmes postës elektronike ka dërguar tek Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit Letër konfirmim Ref. 860/2025 datë 24.01.2025 nga Ministria e Punëve të Brendshme- Departamenti për OJQ me të cilin vërtetohet se: [...] ***Përfaqësues i autorizuar në OJQ-në “Agjencia për Financim në Kosovë” është V.A, Drejtor Ekzekutiv.***

Lidhur me pretendimin se Edmond Beqiri, është edhe Kryetar Bordi në OJQ-në: “Agjencia për Financim në Kosovë”, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit më datë 21.11.2024 ka pranuar një Dokument Sqarues nga OJQ-ja “ Agjencia për Financim në Kosovë” në të cilin thuhet: [...] *“Angazhimi i anëtarëve të Bordit është vullnetar, me faktin që për aktivitetet e lidhura me AFK iu kompensohen shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzime të tjera të arsyeshme”.*

Nga veprimet e ndërmarra nga z. Edmond Beqiri, duke hequr dorë nga funksioni i personit të autorizuar dhe Kryetarit të Bordit në OJQ-në “Agjencia për Financim në Kosovë” janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur papajtueshmëria në ushtrim të funksionit publik.

Ndërsa angazhimin apo pjesëmarrja si anëtar Bordi në OJQ-në “Agjencia për Financim në Kosovë” si punë vullnetare ku kompensohen vetëm shpenzimet e udhëtimit dhe ato të arsyeshme nuk bie ndesh me dispozitat e LPKI-së, kjo për faktin se është përcaktuar edhe në Nenin 14, paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ku thuhet: *“Zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues, me përjashtim të funksionit drejtues, të organizatës joqeveritare nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës, veprimtarive humanitare dhe të ngjashme pa të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me to”.*

Me veprimet tashmë të ndërmarra nga zyrtari i lartë, janë krijuar rrethana të reja me çfarë është shmangur gjendja e papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


Yll Buleshkaj
Drejtor i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit



Rolls
FOR PROVISION
FOR NO. 1000